



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 974/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, paraqitur kundër Besim Hoxha nga rradhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prizren, për shkak të parregullsive për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren.

Arsyetim

PZAP-i , më datën 01.12.2013, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK me të cilën pretendohet se në ditën e votimit Besim Hoxha nga rradhët e LDK është hasur duke i fotografuar pa autorizim anëtarët e PDK-së në Sh.M. 11 Marsi në Prizren dhe duke bërë shkelje të rregullave të votimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore të theksuara në ankesë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe në dëshmi bindëse ngase parashtresuesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë shtese ankesës së parashtruar me të cilat do të mund të administrohej lënda, ose do të mund të verifikohesh vërtetësia e shkeljes së pretenduar. Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar shkeljet që janë

cekur ne ankese , PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 974/2013 më datën 02.12.2013.

Kryesuesi Paneli
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.